



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:005382  
Datë: 15.08.2024  
Numri i dokumentit: 06052035

CAP.nr.1105/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike – përmbartimore të kreditorit N.P. “Termokos” Sh.A. me seli në Prishtinë, kundër debitorit: I.H nga Prishtina, me objekt të përmbartimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.3/2022 i datës 29.12.2022, me datë 12.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit N.P. “Termokos” Sh.A. me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.3/2022 i datës 29.12.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.3/2022 të datës 29.12.2022, ka aprovuar të bazuar prapësimin e debitorit I.H nga Prishtina, ndërsa ka shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.1720/21 datë 03.12.2021 të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka në Prishtinë, dhe ka anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori N.P. “Termokos” Sh.A. me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata

e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar të prishet aktvendimi i ankimuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat Valdrin Beka në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me seli të zyrës në Prishtinë, si organ përmbarues, me urdhrin P.nr.1720/21 i datës 03.12.2021, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit N.P. "Termokos" Sh.A. ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit I.H nga Prishtina, në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës së Kontabilitetit të Konsumatorit të Kreditorit me numër identifikues: ////, me shifër të blerësit: ///, për ofrimin e shërbimeve të ngrohjes, në shumë prej 733.38 Euro.

Kundër këtij urdhri mbi lejjimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilën e ka kontestuar në tërësi Urdhrin për Përmbarim të atakuar me Prapësim, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka theksuar se kreditori nuk ka paraqitur të dhëna të sakta gjatë përlllogaritjes së borxhit ka bërë kalkulim të gabueshëm dhe borxhi i kërkuar nuk përputhet me shërbimet e ofruara. Gjithashtu ka theksuar se borxhi deri me datë 30.11.2020 në shumë prej 452,74 euro është parashkruar konform nenit 360 të LMD-së. Andaj edhe i ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin përmbarimorë e atakuar me këtë prapësim.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke i vlerësuar si të pabaza, duke theksuar se qëllimi i vetëm i debitorit është prolongimi i procedurës përmbarimore.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin PPP.nr.3/2022 i datës 29.12.2022 ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se përmbarimi në këtë çështje përmbarimore është caktuar nga ana e përmbaruesit privat, pa u plotësuar kushtet

për nxjerrjen e urdhrit, për faktin se dokumenti në bazë të të cilit është nxjerrë urdhri përmbartimor, gjegjësisht kartela financiare e konsumatorit e lëshuar nga kreditori, në rastin konkret nuk mund të shërbejë si bazë për caktimin e përmbartimit. Më tej, gjykata ka arsyetuar se, urdhri është lëshuar në bazë të Kartelës së Kontabilitetit të Kreditorit me numër identifikues: /// dhe me shifër të blerësit ///, për ofrimin e shërbimit të ngrohjes, për borxhin në shumë prej 733.38 euro, ndërsa në petitumin e Propozimit për Përmbartim nuk është specifikuar fare periudha kohore nga ana e kreditorit për cilën periudhë e kërkon përmbartimin e borxhit. Më tej, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se urdhri për përmbartim përmban një kërkesë, detyrimi i së cilës nuk mund të ekzaminohet sipas dokumentit të besueshëm të bashkangjitur propozimit për përmbartim. Kjo për faktin se në propozim për përmbartim nuk është specifikuar periudha kohore për të cilën kërkohet përmbartimi, ndërsa në mungesë të specifikimit të periudhës kohore nga kreditori gjykata e pati të pamundur vlerësimin e parashkrimit sipas pretendimit të parashtruar në prapsim.

Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e nenit 38, 43, 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ku pala ankuese nuk thirret në asnjë dispozitë të LPK-së, por nga përmbajtja e ankesës ceket se aktvendimi i ankimuar nuk është gjykuar në bazë të provave të deponuara, e nga kjo thënie rezulton se kemi të bëjmë me dispozitën e nenit 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin të prapësimin të debitorit dhe shfuqizimit të urdhrit për përmbartim P.nr.1720/21 datë 03.12.2021, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Me dispozitën e nenit 29 par.3 të LPP-së përcaktohet “dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti,

lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa neni 38 par 1 i LPP –së, përcakton se: “Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”, ashtu që pas analizimit të shkresave të lëndës, shihet se kreditori në propozimin për përmbarim nuk ka specifikuar periudhën për të cilën kërkon borxhin, element ky i nevojshëm për zbatimin e përmbarimit, prandaj, pasi që nuk dihet periudha për të cilën kërkon borxhin, nuk mund të pranohet as ekstrakti me saldo fillestare në lartësi prej 733.38 euro, andaj vlerësimin e gjykatës së shkallës lidhur me aprovimin e prapësimit dhe shfuqizimin e Urdhrit Përmbarimor, e sheh si të drejtë dhe në harmoni të plotë me dispozitat ligjore edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit por të cilat nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë dhe se për këtë arsye gjykata ankimore ka vendosur që t’i refuzojë ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1105/2023 me datë 12.08.2024

Gjyqtarja  
Frosina Sylejmani